



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

VENDIM

Nr. 5, datë 27.2.19

Përcaktimin e afateve për dorëzimin e doktoraturave në proces

Në mbledhjen e datës 27.02.2019, Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike, nisur nga problematika e krijuar nga studentët e doktoraturës si dhe punonjësit shkencorë në ASA, të cilët nuk i kanë realizuar doktoraturat në kohë, duke i tejkaluar të gjitha afatet ligjore vendosi që:

- Të gjithë ata që kanë kaluar 6 vjet dhe janë ende në proces, t'u caktohet 1 shtatori 2019 si datë për dorëzimin e doktoraturave dhe deri brenda dhjetorit 2019 të realizohet mbrojtja e tyre.
- Për mos realizim të këtyre afateve do të ndiqen të gjitha dispozitat ligjore që janë në fuqi.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

AKADEMIK PROF. DR. MARENGLIN VERLI

